



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**RREGULLORE**

**MBI KRITERET E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË MBROJTURA**

(Miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 68, datë 20.04.2018)

**KREU I  
TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve për ofrimin e shërbimeve të mbrojtura, për të siguruar shërbim me cilësi tek abonentët, në kushte të ndershme, të arsyeshme dhe jo diskriminuese

**Neni 2  
Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në rast se nuk janë të përkufizuar në ligj, do të jenë në përputhje me direktivat e BE-së dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi në fushën e mediave audiovizive.

2. Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Shërbime të mbrojtura” janë shërbime të transmetimit audio dhe/ose audiovizive dhe shërbime të shoqërisë së informacionit që ofrohen për qëllime fitimi mbi bazën e aksesit të kushtëzuar si dhe ofrimi i aksesit të kushtëzuar për shërbimet e transmetimit audio dhe/ose audiovizive.
- b) “Akses i kushtëzuar” është çdo masë dhe/ose rregullim teknik që mundëson marrjen në formë të kuptueshme të shërbimeve të mbrojtura, kundrejt një autorizimi individual paraprak. Aksesit i Kushtëzuar është një shërbim ndërmjetës që realizon abonimin në shërbimet televizive. Ai mund të kërkohet edhe nga shërbimet pa pagesë (free-to-air)

- c) “Udhëzuesi Elektronik i Programit” është mënyra elektronike e informimit të publikut lidhur me listën dhe orarin e programeve nga shërbimi i transmetimit, e cila është pjesë përbërëse e sistemit të transmetimit.
- d) “Pajisje e ndaluar” është çdo pajisje ose program i projektuar ose i përshtatur për dhënien e aksesit në një shërbim të mbrojtur në një formë të kuptueshme, të qartë, pa autorizimin e ofruesit të shërbimit.

### **Neni 3** **Fusha e zbatimit**

1. Ofruesit e shërbimeve me akses të kushtëzuar (OSHAK), pavarësisht nga mënyra e transmetimit, zbatojnë kërkesat e kësaj rregulloreje.
2. Kjo rregullore zbatohet për subjektet e licencuara për transmetime numerike tokësore dhe për shërbimin e programit audioviziv dhe/ose të autorizuar për ofrimin e shërbimit mediatik (OSHMA) mbështetur në rrjete jashtë brezit të frekuencave të caktuar për transmetime televizive.

### **Neni 4** **Autorizimi i Shërbimit me Akses të Kushtëzuar për transmetimet tokësore**

1. Subjekti i licencuar për transmetime numerike tokësore dhe për shërbimin e programit audioviziv dhe subjektet e autorizuar për ofrimin e shërbimit mediatik mbështetur në rrjete jashtë brezit të frekuencave konsiderohet i autorizuar edhe për ofrimin e shërbimeve me akses të kushtëzuar.
2. Përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, nuk përjashton mundësinë e dhënies së autorizimit për ofrimin e shërbimeve me akses të kushtëzuar për çdo të subjekt të interesuar.

### **Neni 5** **Ofrimi i Shërbimit me Akses të Kushtëzuar**

1. I autorizuari për shërbimin e aksesit të kushtëzuar nuk lejohet t’i ofrojë shërbimet e aksesit të kushtëzuar, subjekteve të palicencuar/autorizuar nga AMA si OSHMA.
2. Mënyra e ofrimit të shërbimit audioviziv për publikun (me pagesë ose jo) nga të licencuarit për transmetime numerike tokësore ose ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive që mbështeten në rrjete numerike tokësore, përcaktohet në kushtet e licencës së miratuar.

## **KREU II**

### **OFRIMI I SHËRBIMEVE ME AKSES TË KUSHTËZUAR**

#### **Neni 6**

##### **Objektivat**

1. Ofrimi i shërbimit me akses të kushtëzuar (SHAK) duhet:
  - a) Të mos përdoret për të shtrembëruar, kufizuar apo parandaluar konkurrencën në shërbimet televizive dhe shërbimet e tjera të përmbajtjes.
  - b) Të mos kufizojë zgjedhjen e konsumatorit, si në lidhje me pajisjet e konsumatorit, numrin e shërbimeve të këtyre pajisjeve apo në paketimin e këtyre shërbimeve;
  - c) Të thjeshtojë për aq sa është e mundur aksesin e konsumatorit në më shumë se një mekanizëm lëvrimi, pa përdorur shpenzime të panevojshme shtesë;
  - d) Të thjeshtojë zgjedhjen e konsumatorit duke siguruar aksesin e lehtë në një informacion të kuptueshëm mbi numrin e shërbimeve të disponueshëm dhe zgjedhjen e lehtë të shërbimeve;
  - e) Të sigurojë përdorimin e kësaj teknologjie nëpërmjet çmimeve të favorshme në treg.

#### **Neni 7**

##### **Tarifat për Shërbimit me Akses të Kushtëzuar**

Shërbimet me akses të kushtëzuar duhet të ofrohen në kushte të drejta, të arsyeshme dhe me çmime jodiskriminuese.

#### **Neni 8**

##### **Detyrimet e OSHAK**

1. OSHAK është i detyruar t'u ofrojë shërbime të aksesit të kushtëzuar nëpërmjet çdo dekoderi që mund të marrë sinjalet e tyre, OSHMA-ve të licencuar nga AMA, në baza të ndershme, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.
2. OSHAK nuk lejohet të ofrojë shërbime të aksesit të kushtëzuar duke abuzuar me pozicionin dominues ose duke lidhur marrëveshje në dëm të konkurrencës së ndershme.
3. OSHAK nuk lejohet të kushtëzojë shitjen e një shërbimi të aksesit të kushtëzuar me shitjen e një shërbimi tjetër.
4. Ndërfaqet e përdorura për ofrimin e shërbimit të aksesit të kushtëzuar duhet të plotësojnë kërkesat kryesore për të lejuar ndërveprimin me sistemin e aksesit të kushtëzuar.
5. OSHAK nuk duhet të tregojë preferencë apo diskriminim të papërshtatshëm kundrejt OSHMA-ve specifike. Ky detyrim zbatohet veçanërisht për:
  - a) ofrimin e shërbimit të aksesit të kushtëzuar për shërbimet e programeve audiovizive të veta apo të grupit, kundrejt palëve të treta;

- b) ofrimin e shërbimit të aksesit të kushtëzuar për shërbimet e programeve audiovizive të disa palëve të treta.
6. OSHMA e pajisur me licencë/autorizim për ofrimin e shërbimeve mediatike, që ofron shërbimin me akses të kushtëzuar duhet të mbajë llogari të veçanta për këtë lloj shërbimi.
  7. OSHAK ka detyrim të ndryshojë sistemin e aksesit të kushtëzuar nëse dështon në respektimin e kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe kësaj rregulloreje lidhur me kërkesat për kapacitete, sigurinë e sistemit, ndërfaqeve me sistemin apo çdo software tjetër që vepron nëpërmjet sistemit të aksesit të kushtëzuar dhe është bërë teknikisht e vështirë apo e pamundur për t'u ofruar OSHMA-ve shërbime të aksesit të kushtëzuar në baza të ndershme, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.
  8. Sistemet e aksesit të kushtëzuar për shërbimet audiovizive numerike duhet të kenë kapacitetet e nevojshme teknike për të mundësuar që operatorët e rrjeteve të kenë kontrollin e plotë mbi shërbimet që përdorin këto sisteme. OSHAK duhet të garantojë pavarësinë operationale të OSHMA-së që merr shërbimin e aksesit të kushtëzuar.

## **Neni 9** **Ofrimi i SHAK**

1. Ofruesi i shërbimit me akses të kushtëzuar, pas marrjes së kërkesës për shërbimin me akses të kushtëzuar nga një palë e tretë, brenda 30 ditësh nga marrja e kërkesës i paraqet kërkuarit një ofertë me shkrim për shërbimin. Në rast se ofruesi i shërbimit me akses të kushtëzuar, nuk përgjigjet brenda afatit të mësipërm, konsiderohet refuzim i dhënies së shërbimit ose diskriminim i papërshtatshëm.
2. OSHAK, përcakton kushtet e kontratës në ofertën e shërbimit. Oferta e shërbimit përmban:
  - a) çmimin;
  - b) datën e fillimit të shërbimit;
  - c) informacion mbi mënyrën e funksionimit të sistemit dhe funksionet që mbështeten nga sistemi i Aksesit të Kushtëzuar, përfshirë funksionet e ndërfaqeve/përshtatësit e programeve të aplikimit si dhe Udhëzuesin Elektronik të Programeve (UEP);
  - d) detaje të çdo ndërfaqeje kryesore;
  - e) kritere për zëvendësimin e kartave, për arsye sigurie.

## **Neni 10** **Kontrata me OSHMA-të**

Bazuar në ofertën e shërbimeve, OSHAK dhe OSHMA lidhin një kontratë shërbimi ku parashikohen kushtet e ofrimit të shërbimit me akses të kushtëzuar.

## **Neni 11** **Trajtimi i disavantazhit konkurrues**

1. OSHAK duhet t'u ofrojnë OSHMA asistencë teknike në kushte të ndershme. Rastet kur një OSHMA vendoset në disavantazh konkurrues përfshijnë rastet e mëposhtme:
  - a) OSHMA-së i refuzohet informacioni thelbësor mbi kushtet e kontratës, ose mbi funksionet e sistemit të aksesit të kushtëzuar dhe software-it shoqërues;
  - b) OSHMA detyrohet të bëjë pjesë në një paketë programore të një OSHMA-je të lidhur me OSHAK-un;
  - c) OSHMA detyrohet t'i japë emrat dhe adresat e abonentëve të tij, OSHAK-ut, pavarësisht se këto të dhëna mund të sigurohen në mënyra alternativa dhe me kosto të arsyeshme.
  - d) OSHMA nuk ka akses në të dhënat mbi abonentët e tij, veçanërisht nëse të dhëna të ngjashme disponohen nga një OSHMA tjetër i lidhur me OSHAK-un.
  - e) OSHMA detyrohet t'i japë informacion OSHAK-ut mbi planet e ardhshme për shërbimin e programit të tij.

## **Neni 12**

### **Të drejtat e OSHMA**

1. Shërbimi i aksesit të kushtëzuar ofrohet në mënyrë të tillë që secili OSHMA të jetë i aftë të bëjë një apo disa nga veprimet e mëposhtme pa shpenzime të panevojshme apo të papërshtatshme, pa vonesa apo vështirësi:
  - a) të mbajë një marrëdhënie direkte kontraktore me abonentët;
  - b) të operojë shërbimin e tij të administrimit të abonentëve;
  - c) të mbajë konfidenciale të dhënat e abonentëve të tij.

## **Neni 13**

### **Autorizimi i pavarur i abonentit**

1. Detyrimi për të ofruar shërbime të aksesit të kushtëzuar në baza të ndershme, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, përfshin dhënien e mundësisë OSHMA-së për të autorizuar abonentët apo për t'i ç'aktivizuar ata në mënyrë të pavarur nga OSHAK.
2. OSHAK siguron që sistemi i aksesit të kushtëzuar të lejojë administrimin e të dhënave të kartave (smart cards) që abonenti të zgjedhë kombinimin e shërbimeve të OSHMA-ve që ai dëshiron të marrë.

## **Neni 14**

### **Shërbimet e lidhura**

1. Shërbimet e aksesit të kushtëzuar që i ofrohen një OSHMA-je nuk duhet të shoqërohen me shërbime të tjera në rast se OSHMA nuk është dakord.
2. OSHAK shkel detyrimin e mësipërm, nëse:

- a) kushtëzon ofertën për dhënien e një shërbimi me pranimin e ofrimit edhe të një shërbimi tjetër të ofruar nga OSHAK ose që bën pjesë në grupin e OSHAK-ut, përveç rastit kur shërbimi i ofruar nuk mund të transmetohet ndryshe;
- b) ndërpret ofrimin e çdo shërbimi apo informacioni të nevojshëm në mënyrë që OSHMA të detyrohet të blejë nga OSHAK shërbime të padëshiruara.

### **Neni 15**

#### **Shërbimet e ofruara në baza të pandershme dhe të paarsyeshme**

1. Termat e ofruara për një shërbim të kërkuar të aksesit të kushtëzuar nuk duhet të përmbajnë asnjë kërkesë që mund të shtrembërojë konkurrencën. Kërkesat e mëposhtme konsiderohen si shkelje të ofrimit të shërbimit në baza të ndershme, të arsyeshme dhe jo diskriminuese:
  - a) kërkesa kundrejt OSHMA-së të japë detaje të aktivitetit të tij tregtar që nuk kërkojnë për ofrimin e shërbimit;
  - b) kërkesa kundrejt OSHMA-së të futet në paketë programore të një shoqërie të lidhur me OSHAK;
  - c) kërkesa kundrejt OSHMA-së të japë informacione të abonentëve të tij;
  - d) refuzimi për të dhënë informacion të nevojshëm për ofrimin e shërbimit, kur ky informacion disponohet nga OSHAK;
  - e) refuzimi për dhënien e informacionit mbi modelet e shikueshmërisë kundrejt shërbimeve të OSHMA-së kur të dhënat mbahen nga OSHAK, apo të dhëna të përgjithshme të shikueshmërisë, kur të dhëna të ngjashme u janë dhënë OSHAK-ut;
  - f) parashikimi i kriterëve rënduesë për marrjen e shërbimit të aksesit të kushtëzuar.

### **Neni 16**

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. OSHMA, në rast se pretendon se OSHAK ka shkelur kërkesat e kësaj rregulloreje, ka të drejtë:
  - a) të depozitojë një ankesë me shkrim në AMA, i cili fillimisht kërkon nga palët zgjidhjen e mosmarrëveshjes me pajtim.
  - b) të kërkojë në gjykatën kompetente shpërblimin e dëmit të shkaktuar prej ofruesit të shërbimit me akses të kushtëzuar.
2. Ofruesit e shërbimeve me akses të kushtëzuar, interesat e të cilëve cenohen nga një veprimtari e paligjshme të kryer me anë të pajisjeve të ndaluara, kanë të drejtë të kërkojnë kompensim për dëmin e shkaktuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **KREU III**

### **UDHËZUESI ELEKTRONIK I PROGRAMIT**

### **Neni 17**

#### **Udhëzuesi Elektronik i Programit (UEP)**

1. Udhëzuesi Elektronik i Programit (UEP) është mënyra elektronike e informimit të publikut lidhur me listën dhe oraret e programeve të shërbimit.
2. UEP është pjesë e sistemit të aksesit të kushtëzuar. Ky shërbim ofrohet në baza të ndershme, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.

## **Neni 18**

### **Konkurrenca**

1. UEP reflekton nevojat dhe preferencat e abonentëve. Ofrimi i këtij shërbimi dhe çdo shërbimi tjetër që ndihmon abonentët të kërkojnë nëpërmjet opsioneve të disponueshme, nuk duhet të kufizojë, shtrembërojë apo ndalojë konkurrencën.
2. UEP duhet të jetë neutral nga pikëpamja e konkurrencës për të gjithë ofruesit e shërbimeve audiovizive. Kërkesat për neutralitetin konkurrues cenohen në rastet kur:
  - a) një ofrues shërbimi i lidhur me një ofrues UEP ka përfituar kushte aksesit (financiare apo të tjera) më të favorshme se kushtet e ofruara për OSHMA-të e tjerë;
  - b) shërbimet pa pagesë (free-to-air) mund të arrihen vetëm nëpërmjet faqeve që përmbajnë detaje të shërbimeve me pagesë (pay);
  - c) ndërtimi i UEP-së është i tillë që shërbimet e vetëm të një ofruesi të arrihen më lehtë se shërbimet e ofruesve të tjerë;
  - d) shërbimeve të një ofruesi u jepet përparësi e papërshtatshme;
  - e) disa ofruesve, por jo të gjithëve u jepet mundësia të shfaqin markën e shërbimit;
  - f) karakteristika speciale të UEP-së u vihen në dispozicion disa shërbimeve, por jo të tjerëve.

## **Neni 19**

### **Shërbimet pa pagesë (free-to-air)**

1. Të gjithë dekoderët në shitje duhet të kenë aftësinë të marrin dhe shfaqin transmetimet e hapura (free-to-air). Udhëzuesi Elektronik i Programit i inkorporuar në këta dekoderë siguron që shërbimet e hapura të shfaqen në ekran dhe të zgjidhen nga shikuesit pa i detyruar ata të paguajnë ndonjë tarifë.
2. Informacionet që shfaqen në UEP duhet të jenë në gjuhën shqipe.

## **Neni 20**

### **Shfaqja e shërbimeve të ofruara në platforma të ndryshme**

1. UEP i destinuar të ofrojë akses në shërbimet e një platforme nuk ka detyrim të ofrojë informacion mbi aksesin në shërbimet e një platforme tjetër.
2. Pavarësisht parashikimit të pikës 1 të këtij neni, nëse jepet një informacion i tillë, e njëjta lehtësi duhet të jetë e disponueshme për të gjitha shërbimet në platformën e dytë.

## **KREU IV PAJISJET E NDALUARA**

### **Neni 21 Aktivitete të ndaluara**

1. Prodhimi, importimi, shpërndarja, shitja, dhënia me qira ose posedimi për qëllime tregtare i pajisjeve të ndaluara nuk lejohet.
2. Instalimi, mirëmbajtja ose zëvendësimi për qëllime tregtare të një pajisje të ndaluar nuk lejohet.
3. Përdorimi i komunikimeve tregtare audio dhe ose audiovizive dhe çdo lloj reklame për promovimin e pajisjeve të ndaluara nuk lejohet.

### **Neni 22 Sanksione**

1. Mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në nenin 21 të kësaj rregulloreje, kur nuk përbën veprë penale, ndëshkohet me gjobë nga 100 000 deri në 2 000 000 lekë.
2. AMA, në marrjen e vendimit të tij, merr në konsideratë:
  - a) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes;
  - b) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë;
  - c) rëndësinë e kundërvajtjes;
  - ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi.
3. Në rast konstatimi të veprimtarisë së paligjshme sipas nenit 21 të kësaj rregulloreje, AMA bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, dhe, kur e sheh të arsyeshme, kërkon nxjerrjen jashtë tregut të pajisjeve të paligjshme.

### **Neni 23 Hyrja në fuqi dhe publikimi**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga AMA dhe publikohet në faqen e internetit të AMA-s.